



## Projekti SuProm- “Sustainable project management in Balkan HEIs” (Manaxhimi i qëndrueshëm i projekteve në IAL-të e Ballkanit)

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është partner në projektin Erasmus-LS me titull **SuProm - “Sustainable project management in Balkan HEIs” (Manaxhimi i qëndrueshëm i projekteve në IAL-të e Ballkanit)**, projekt i cili ka një kohëzgjatje 2-vjeçare dhe ka si qëllim kryesor modernizimin e arsimit të lartë. Ky projekt është një përgjigje direkte e sfidës për manaxhimin e qëndrueshëm të projekteve në rajon dhe reformës në arsimin e lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Synimi i këtij projekti është të ofrojë një mbështetje sistematike për IAL-të në Ballkanin perëndimor në mënyrë që të përmirësojnë njohuritë e tyre rreth çështjeve të manaxhimit të projekteve dhe të ofrojë mbështetje në rritjen e aftësive nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve për manaxhimin e projekteve për stafin e IAL-ve dhe më tej hartimin e kurseve dhe përmirësimin e kurrikulave nëpërmjet përfshirjes së moduleve për manaxhimin e projekteve për studentët.

### Objektivi i përgjithshëm

*Projekti ka si objektiv të përgjithshëm ofrimin e trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve në menaxhimin e qëndrueshëm të projekteve dhe integrimin e moduleve të manaxhimit të projekteve në programet dhe kurrikulat e arsimit të lartë.*

Përmirësimi i aftësive të menaxhimit të projekteve të stafit dhe studentëve të universitetit, rritja e punësimit të studentëve dhe pajisja e stafit të universitetit me njohuri të përparuara për menaxhimin e projekteve ndërkombëtare janë hapa të nevojshëm për t'i mundësuar stafit dhe studentëve të koordinojnë ose të bëhen partnerë në mënyrë efektive në projekte të financuara nga BE-ja dhe kështu të përmirësojnë performancën institucionale në programet evropiane.

### Objektiva të tjera:

- Analizimi i praktikave aktuale të menaxhimit të projekteve brenda institucioneve të arsimit të lartë.



- Angazhimi i palëve të interesuara në të gjithë komunitetin akademik përmes trajnimeve të synuara për maaxhimin e projekteve.
- Rritja e kapacitetit afatgjatë të menaxhimit të projekteve përmes kurseve të qëndrueshme të menaxhimit të projekteve në kurrikulat e arsimit të lartë.

### **Të dhëna të përgjithshme:**

Numri i projektit: **101177983**

Emri i projektit: **“Sustainable project management in Balkan HEIs” (Manaxhimi i qëndrueshëm i projekteve në IAL-të e Ballkanit)**

Akronimi i projektit: **SuProM**

Thirrja: **ERASMUS-EDU-2024-CBHE**

Tema: **ERASMUS-EDU-2024-CBHE-STRAND-1**

Lloji i veprimtarisë: **Erasmus – LS**

Autoriteti financues: **EACEA**

Data e fillimit të projektit: **1 Janar 2025**

Data e përfundimit të projektit: **31 Dhjetor 2026**

Kohezgjatja e projektit: **24 muaj**

### **Financues:**

**Agjencia Ekzekutive Evropiane e Arsimit dhe Kulturës (EACEA)** (‘agjenci ekzekutive e BE-së’ ose ‘autoriteti që jep grantin’), sipas kompetencave të deleguara nga Komisioni Evropian.

### **Përfitues:**

#### **Koordinatori i projektit :**

- **Universiteti i Ljubljanes (UL)**

#### **Partnerët e projektit:**

- **Universiteti i studimeve të Palermos (UNIPA)**
- **Qendra Evropiane për Studime dhe Iniciativa (CESIE ETS)**
- **Unioni i Universiteteve Mesdhetare (UNIMED)**
- **Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (UNIEL)**
- **Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” (UTV)**
- **Universiteti “Fan s.Noli” Korçë (UNKO)**
- **Universiteti i Tuzlit “Javna Ustanova” (UNITZ)**
- **Universiteti i Mostarit (SUM)**

